



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Kiga Sh.P.K. & Liki Group Sh.P.K." të datës 18.09.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 11.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Kiga Sh.P.K. & Liki Group Sh.P.K." e datës 18.09.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 11.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Kiga Sh.P.K. & Liki Group Sh.P.K." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Kiga Sh.P.K. & Liki Group Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 18.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 11.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

**Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim: "Operatori i rekomanduar për kontratë DHF COMPANY shpk e ka dorëzuar Listën siç është kërkuar në dosje të tenderit por nuk e ka dorëzuar asnjë reference ose certifikate për kryerjen e furnizimeve. Listën të cilën e ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë e ka përpiluar te teren se kinse i ka furnizuar Operatoret Ekonomik por nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi pasi që është dashur që ta paraqes edhe dëshminë nga banka se me të vërtetë e ka kryer atë furnizim në të kundërtën nëse e ka kryer atë furnizim dhe nuk kanë qarkulluar paratë nëpërmjet bankës atëherë këta Operatore që gjenden në liste dhe Operatori i rekomanduar për kontratë iu kanë ikur tatimeve dhe kanë kryer vepër penale".**

**Sa i përket pretendimeve ankimore, fillimisht duhet cekur se ky pretendim ka të bëjë me kërkesën vijuese të dosjes së tenderit:**

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional 1.Operatori duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontratë për furnizime të ngjashme (lende djegese) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë jo me pak se 400.000,00.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.
---	-----------	--	---

Nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar si provë në këtë rast është gjetur se i njëjti ka dorëzuar dëshminë e kërkuar dokumentare "listën e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit...(në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 400,000.00 euro)". Përndryshe nga formulimi i pretendimit mund të konfirmohet se as vet parashtruesi nuk e konteston që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar listën e kontratave. Sidoqoftë me datë 18.08.2023 është dërguar një letër standarde për sqarime shtesë për tenderuesin e rekomanduar i cili me datë 28.08.2023 është përgjigjur në këtë kërkesë duke dërguar edhe dokumentet shtesë të kërkuara si dëshmi pikërisht për listën e kontratave sipas kërkesës përkatëse të dosjes së tenderit.

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 19.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)